



SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË

PEJË



SOLIDAR
SWITZERLAND
Swiss Labour Assistance SLA

2017



Syri i Vizionit

Ky publikim u mundësua në kuadër të projektit ProKarriera, të cilin organizata joqeveritare “Syri i vizionit” është duke e implementuar me mbështetjen financiare të Solidar Suisse. Projekti ka për qëllim fuqizimin e shërbimit të këshillimit në karrierë nëpër shkolla për të ndihmuar të rinjtë të përshtaten sa më mirë me tregun e punës.

SHKOLLA SOT:

Edhe pse që nga themelimi i saj ende pa objekt të saj, Shkolla e mesme e mjekësisë në Pejë, është ndër shkollat më të preferuara. Me gjashtë drejtimet ekzistuese shkolla konsiderohet si një mundësi për t'u regjistruar pastaj në studimet e larta për mjekësi, një profesion ende i preferuar në Kosovë me gjithë numrin e madh të mjekëve që dalin çdo vjet. Në vitin shkollor 2017-2018, Shkolla e Mjekësisë starton me objekt të ri, jo shumë larg nga Spitali i Pejës, Shkolla pranon nxënës të rajonit edhe nga komuna tjera fqinje jashtë komunës së Pejës, kurse mësimi zhvillohet në dy gjuhë, shqip dhe boshnjakisht.

Në vitin shkollor 2016/2017 janë 19 paralele mësimi në gjuhën shqipe dhe 3 në gjuhën boshnjake, në të cilat mësimin ndjekin 645 nxënës.



DREJTIMET:

Shkolla ka këto profile: Teknik i Farmacisë, Teknik i dhëmbëve, Ndhmës infermier i përgjithshëm, Ndhmës infermier i mamisë, Laborant mjekësor, Ndhmës infermier i pediatriisë dhe Asistent i stomatologjisë. Të njëjtat janë edhe në gjuhën boshnjake duke ndryshuar profilin nga njëri vit në tjetrin.

Në mundësi për t'u futur ndërkohë janë Fizioterapia, Radiologjia, Geriatrika, etj., duke sjellë risi nga viti në vit dhe duke plotësuar ofertën për drejtime të duhura mjekësore, bazuar edhe në interesimin e nxënësve.

Në Shkollën e Mjekësisë nuk është i mundur shkollimi me korrespondencë.



HISTORIK:

Shkolla e mesme e mjekësisë në Pejë është hapur më vonë dhe ka më pak histori sesa shkollat tjera profesionale në këtë komunë. Është krijuar gjatë dekadës së nëntëdhjeta të shekullit të kaluar në vitin 1996. Që nga themelimi ajo nuk ka pasur një objekt të vetin duke funksionuar fillimisht në objektin e shkollës fillore “Tetë marsi” para luftës, e pas luftës në objektin shkollës fillore “Ramiz Sadiku”, ku ka funksionuar bashkë me këtë shkollë nën një çati për 18 vjet. Në të kaluarën shkolla ka pasur edhe paralelet e ndara në Istog dhe Klinë, por tani është reduktuar vetëm në Pejë.



KAPACITETET:

Mungesa e objektit në vazhdimësi ka pasur një rol shumë të keq në zhvillimin e institucionit. Ajo ka funksionuar pa shumë nga kushtet e domosdoshme, edhe pse nxënësit kanë arritur sukseset edhe në këtë gjendje. Aktiviteti është zhvilluar në katin e dytë të shkollës në orarin e pasdites, bashkërisht me pjesën tjetër të shkollës fillore “Ramiz Sadiku”. Por gjatë vitit 2017, Komuna e Pejës është duke përfunduar së ndërtuari objektin e veçantë dedikuar kësaj shkolle, që për herë të parë do të ketë objektin e vet për zhvillimin e mësimi. Objekti ndodhet afër Spitalit të Pejës, në një sipërfaqe prej 3 mijë metra dhe dy kate, që do të zgjidh një herë e përgjithmonë këtë problem që e ndjek shkollën nga themelimi. Objekti do ketë 12 klasë mësimi, tri kabinete, një fushë sportive, ndërsa në plan më vonë është edhe një palestër sportive. Objekti do jetë në dispozicion për shkollën në fillimin e vitit të ri më 1 shtator 2017. Sipas planifikimit kapacitetet e shkollës nuk do të janë më të mëdha as pas kalimit në objektin e ri pasi edhe tani klasat janë të mbingarkuara me nxënës.



PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Shkolla është e përfshirë në projektet e reformave në arsimin kosovar në përgjithësi, kurse mësimmhënësit e saj kanë ndjekur trajnimet për aftësim në punë. Nxënësit e kësaj shkolle rregullisht kanë treguar rezultate të mira në testin e maturës, ka kanë qenë ndër më të dalluarit në Komunën e Pejës. ata kanë marrë pjesë edhe në gara e aktivitete me shkollat tjera, ku kanë treguar arritje dhe rezultate të mira.

Investimet e deritanishme në objektin e kësaj shkolle, kryesisht kanë qenë në përmirësimin të shpejtë të gjendjes në shkollë, dhe që tani i takojnë së kaluarës pas ndarjes nga shkolla “Ramiz Sadiku”.

Kurse sa i përket bashkëpunimit, shkolla bashkëpunon mirë me Spitalin rajonal të Pejës, ku nxënësit e kryejnë praktikën profesionale një ditë në javë, por edhe me sektorin privat, farmacitë dhe ambulancat stomatologjike.



PSE TË REGJISTROHEM NË KËTË SHKOLLË?

Në këtë shkollë nxënësit regjistrohen pasi është një sektor që ka përparësi në punësim dhe konsiderohet që nxënësit e Shkollës së mjekësisë përshtaten me nevojat që ka tregu, si në sektorin publik ku kryesisht punësohen infermierët, mamitë, teknikët medicinalë, etj. Por poashtu edhe tregu privat krijon mundësi sidomos në farmaci, stomatologji, ku të diplomuarit me këto drejtime kanë pasur mjaft kërkesa në periudhën e deritanishme.

Në përgjithësi, shkolla ka drejtime që janë në përputhje me nevojat që ka tregu i punës, ndërsa me shkollim të mëtejme mund të vazhdojnë profilizimin e tyre në drejtimin e shëndetësisë. Shkolla është e preferuar pasi në afatin e regjistrimit ka mjaft kërkesa nga nxënës me sukses të mirë, që ndikon në krijimin e klasave me nivel dhe konkurrencë pozitive mes nxënësve.

Një tjetër përparësi për nxënësit e kësaj shkollë është se kanë mundësi të zhvillojnë praktika profesionale në institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës dhe të Komunës së Pejës.

Për një pjesë të nxënësve që preferojnë të studiojnë mjekësinë në universitet, shkollimi në këtë shkollë konsiderohet si përparësi për t'u regjistruar në fakultetin përkatës në mjekësi.



TREGU I PUNËS

Të diplomuarit në shkollën e mesme të mjekësisë, edhe pse në pjesë të madhe i drejtohen studimeve të mëtejshme në mjekësi, mund të kërkojnë punë edhe me diplomat e arsimit të mesëm, përkatësisht pasi marrin kualifikimin që ua mundëson punësim.

Ata mund të punësohen edhe në sektorin shtetëror, përkatësisht në institucione publike si spitale, ambulanca dhe klinika, por edhe në sektorin privat. Në këto vende pune ata mund të punësohen pa kualifikime të mëtejme.

Ata punësohen në spitale dhe qendra të mjekësisë familjare, si në sektorin shtetëror edhe privat. Në përgjithësi edhe tregu privat ka pasur nevojë për një pjesë të mirë të tyre, pasi të diplomuarit në këtë shkollë gjejnë vende edhe nëpër ambulancat stomatologjike, pediatrike, farmaci, por edhe në institucione tjera që prekin këtë sektor, duke përfshirë edhe sektorin e prodhimit dhe përpunimit farmaceutik, në qendrat e përkujdesjes jo vetëm shëndetësore, por edhe përkujdesje për jetën, etj.

Në rajonin e Pejës ka një sektor të zhvilluar privat të përbërë prej dhjetëra klinikave të tilla private, të të gjitha profileve, që janë të licencuara dhe ofrojnë shërbime shëndetësore. Pa llogaritur që Peja është një qendër rajonale shëndetësore që mbledhë pacientë dhe ofron shërbime dhe në sektorin publik edhe për komunat fqinje.

Me shkollim të mëtejshëm shkolla e mjekësisë mundëson aftësimin për fillimin dhe hapjen e qendrave të shërbimeve mjekësore private, kurse në një kuptim më të gjerë, tregu evropian është i hapur për ata që dëshmojnë ekspertizë në këtë sektor.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Ndihmës infermier i përgjithshëm

Shkollimi për “Ndihmës infermier i përgjithshëm”, niveli I dhe II, i referohet punëve në sektorin e shëndetësisë që janë aktuale. Nisur nga kjo, Ndihmës infermier i përgjithshëm i nivelit I dhe II mund të punësohet në institucione shëndetësore publike dhe private që ofrojnë shërbime shëndetësore.

Farmaci

Shkollimi për “Farmaci”, niveli I, u referohet punëve në ndërmarrjet që merren me ofrimin e shërbimeve në sektorin e farmacisë që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo nxënësi për Farmaci i nivelit I mund të punësohet në ndërmarrje (firma, kompani) që japin shërbime që kanë të bëjnë me teknikun e farmacisë: barnatore, fabrika për prodhimin e barnave oficinale, laboratorët galenikë, fabrikat për prodhimin e mjeteve ndihmëse shëruese, fabrikat për prodhimin e pajisjeve higjienike dhe sanitare, depot farmaceutike, prodhimin dhe shitjen e mjeteve ortopedike, prodhimin dhe shitjen e mjeteve dezinfektuese dhe deratizuese, fabrika për prodhimin e pergadesave kozmetike dhe në shitjen e tyre. Me kualifikime të mëtejshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Ndihmës infermier i pediatriisë

Shkollimi për “Ndihmës infermier i pediatriisë”, niveli I dhe II, i referohet punëve në sektorin e shëndetësisë që janë aktuale. Nisur nga kjo, Ndihmës infermier i pediatriisë i nivelit I dhe II mund të punësohet në institucione shëndetësore publike dhe private që ofrojnë shërbime shëndetësore.

Teknik i dhëmbëve

Shkollimi për “Teknik të dhëmbëve ”, i referohet punimit të dhëmbëve dhe të protezave që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo, tekniku i dhëmbëve mund të punësohet në klinika dhe në laboratorë dentare, ose mund të vetëpunësohet në këtë sektor, sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtëjshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Asistent i stomatologjisë

Shkollimi për “Asistent i stomatologjisë”, i referohet veprimtarive ndihmëse spitalore dhe ambulatorë në sektorët e stomatologjisë, që janë aktuale dhe shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo nxënësi për Asistent të stomatologjisë i nivelit I dhe II mund të punësohet në klinika stomatologjike të të sektorit spitalor, ambulator (privat, shkolla, etj).

Laborant mjekësor

Shkollimi për “Laborant mjekësor”, i referohet kryerjes së punës në laboratorë adekuate të shëndetësisë që shihen me përparësi për të ardhmen në tregun e Kosovës. Nisur nga kjo, tekniku laborant mjekësorë mund të punësohet në klinika dhe në laboratorë adekuate të shëndetësisë, ose mund të vetëpunësohet në këtë sektor, sipas kërkesave të klientëve. Me kualifikime të mëtejshme dhe pas një përvoje pune të konsiderueshme, ai mund të krijojë një biznes të vetin në këtë sektor dhe të punësojë të tjerë.

Ndihmës infermier i mamisë

Shkollimi për “Ndhmës infermier i mamisë”, niveli I dhe II, i referohet punëve në sektorin e shëndetësisë që janë aktuale. Nisur nga kjo, Ndhmës infermier i përgjithshëm i nivelit I dhe II mund të punësohet në institucione shëndetësore publike dhe private që ofrojnë shërbime shëndetësore.

Lëmi	Profili
Shëndetësi	Ndihmës infermier i përgjithshëm
	Asistent i stomatologjisë
	Teknik i dhëmbëve
	Ndihmës infermier i mamisë
	Ndihmës infermier i pediatriisë
	Teknik i Farmacisë
	Teknik Laborant mjekësor

Për më shumë informata lidhur me kriteret dhe afatet e regjistrimit, shikoni konkurset e pranimit të nxënësve në shkolla, ose informohuni direkt në shkollë.



Kontaktet

Adresa e shkollës: Rruga Esad Mekuli, nr.38, Pejë
Telefoni i shkollës: 039 432 676

e-mail: tanidemaj@hotmail.com

Drejtori: Artan Demaj

Tel. 044/ 921 025